



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI  
DREJTORIA E HETIMIT ADMINISTRATIV

Nr. 150/1 Prot.

Tiranë, më 24 . 01 . 2023

**V E N D I M**

**Nr. 14 , Datë 24 . 01 . 2023**

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është regjistruar ankesa nr. 119, datë 08.08.2022, e paraqitur nga S.C<sup>1</sup> dhe e mbështetur nga Fondacioni “Së Bashku<sup>2</sup>”, në të cilën pretendohet diskriminim nga Drejtoria Rajonale e Ofrimit të Formimit Profesional Publik nr. 1, Tiranë (DROFPP), Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE) dhe Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive (AKPA)<sup>3</sup> lidhur me përfitimin nga programet e formimit profesional dhe mosgarantimin e aksesueshmërisë në ambientet e kësaj drejtorie.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri,

**K O N S T A T O I:**

**I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.**

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës, subjekti ankues, në mes të tjerash informon se: “Fondacioni “Së bashku” që prej muajit Prill të vitit 2022 po zbaton nismën “Të rinjtë për gjithëpërfshirjen”. Në kuadër të këtij projekti, nga takimet e zhvilluara me personat me aftësi të kufizuara në Bashkinë Kamëz, konstatoam problematikën e S.C, person me aftësi të kufizuara fizike, e cila kërkon të ndjekë një kurs profesional, për të mundësuar punësimin e saj në të ardhmen. S.C është paraqitur pranë Drejtorisë Rajonale të Ofrimit të Formimit Profesional Publik nr. 1, për të ndjekur një kurs kompjuteri, që zhvillohej në ambientet e kësaj drejtorie dhe kursi do të fillonte me datë 05.08.2022. Si fillim është përballur me një sjellje fyese/tallëse të stafit të Drejtorisë dhe më pas i është parashtruar që meqënëse kursi zhvillohet në katin e dytë,

<sup>1</sup> Referuar Librezës nr. 01167, nr. i serisë 002694, S.C është PAK grupi I (parë).

<sup>2</sup> Fondacioni “Së bashku” është një organizatë jofitimprurëse, regjistruar si person juridik, me vendimi nr. 427, datë 18.06.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, dhe është përfaqësuese me autorizim, e S.C.

<sup>3</sup> Gjatë procedurave hetimore, Komisioneri ka identifikuar si institucione përgjegjëse dhe MFE e AKPA.

*S.C nuk mund ta ndiqte atë. Gjithashtu, godina nuk garanton aksesueshmërinë për personat me aftësi të kufizuar”.*

Sa më sipër, pala ankuese kërkon nga Komisioneri konstatimin e diskriminimit të S.C, në lidhje me përfitimin nga programet e formimit profesional dhe për mosgarantimin e aksesueshmërisë në godinën e DROFPP nr. 1, Tiranë.

## **II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.**

Në nenin 1 të ligjit 10221/2010, *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.*

Bazuar në nenin 7 të ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”<sup>4</sup>*, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi, garantohet ndaj çdo veprimi apo mosveprim të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash.

Bazuar në nenin 32/1/a të ligjit 10221/2010, *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me shkakun e pretenduar nga ankuesi.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar.

**Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32/2 dhe 33 të Ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:**

Pas analizimit paraprak të ankesës nr. 119, datë 08.08.2022, të bërë nga S.C, u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33/3 të ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar. Në këto kushte Komisioneri, filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.

<sup>4</sup> Shkurtesë për Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, të ndryshuar.

- Me shkresën nr. 1135/1, datë 09.08.2022, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka njoftuar dhe kërkuar informacion nga, DROFPP nr. 1, duke vënë në dijeni dhe Agjencinë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive (AKPA), për ankesën e bërë nga S.C si dhe ka kërkuar aktet e poshtë cituara:
  - Informacion mbi përmbushjen e aspekteve që lidhen me aksesueshmërinë për personat me aftësi të kufizuara sipas legjislacionit në fuqi, të godinës së DROFPP nr. 1, shoqëruar me dokumentacion përkatës.
  - Informacion nëse ofrohen kurse të formimit profesional për personat me aftësi të kufizuara? Nëse po, kush janë ato kurse, a ka persona me aftësi të kufizuara që ndjekin kurse të formimit profesional? Informacioni të shoqërohet me kopje të akteve përkatëse provuese?
  - A është bërë nga ana e DROFPP nr. 1, një planifikim i fondeve të nevojshme për përshtatjen/aksesueshmërinë e godinës për personat PAK dhe afatet kohore për realizimin e këtyre investimeve? Nëse po, kopje të dokumentacionit ku janë bërë planifikimet përkatëse financiare dhe afatet kohore.

Me shkresën nr. 791, datë 22.08.2022, DROFPP nr. 1, Tiranë, në mes të tjerash informoi Komisionerin se: *“Lidhur me pretendimet e S.C se është ballafaquar me një sjellje jo korrekte në ambientet e DROFPP nr. 1, ju sqarojmë se ankuesja është paraqitur pranë institucionit për tu regjistruar në kursin “Web design”. Nga ana e stafit i është kërkuar që të paraqiste dokumentacionin e nevojshëm me qëllim regjistrimin dhe ofrimin e një kursi tjetër, pasi kursi që kërkonte zhvillohet në katin e dytë të institucionit, në pamundësi të kushteve të institucionit për ta ndjekur. Ankueses i është bërë me dije se për regjistrim kërkohet: Fotokopje e diplomës së arsimit të mesëm, vërtetim nga zyra rajonale e punësimit me statusin “e papunë” dhe dokument identifikimi. Pasi S.C u njoh me dokumentacionin që duhet për regjistrim i është kërkuar të plotësoj dokumentacionin me qëllim regjistrimin për ndjekjen e një kursi, por ankuesja nuk u paraqit më pranë DROFPP nr. 1, për tu regjistruar. Duke qenë se ankuesja ishte person me aftësi të kufizuara, nga ana e stafit i është sugjeruar ndjekja e kurseve që ofrohen në katin e parë për arsye se kati i parë është i aksesueshëm me rampë për personat me AK.*

*Lidhur me pretendimin se nga ana e stafit ka patur sjellje jo korrekte, menjëherë pasi jemi vënë në dijeni të ankesës kemi telefonuar S.C e cila tha se djali që e ka pritur është sjellë shumë mirë dhe nuk kishte asnjë ankesë, gjë e cila vjen në kundërshtim me ankesën e paraqitur pranë institucionit tuaj. Theksojmë se etika e komunikimit të personit përgjegjës me S.C ka qenë në nivelet e duhura pa përdorur fjalë denigruese dhe fyese, gjë që ka çuar në largimin e zonjës nga institucioni pa ankesa por me falenderime ndaj personin me të cilin ka komunikuar. Specialistët pritës janë me nivel, të trajnuar dhe të ndjeshëm ndaj personave me aftësi ndryshe.*

*Lidhur me aksesueshmërinë për personat me aftësi të kufizuara sqarojmë se DROFPP nr. 1 ka aksesueshmëri për katin e parë dhe është e pajisur me rampë. Kati i parë ofron aksesueshmëri në dhënie e informacionit si duke i dhënë mundësinë për tu ofruar kurse të ndryshme që*

*zhvillohen në këtë kat si: manikyr-pedikyr, parukeri, kuzhinë pastiçeri, etj, (këto kurse ju sugjeruan ankueses si mundësi për ti ndjekur). Kjo dëshmon edhe një herë për vlerësimin dhe prioritetin e DROFPP nr. 1, për personat me aftësi ndryshe.*

*Lidhur me ofrimin e kurseve për personat me aftësi të kufizuar ju bëjmë me dije se pranë DROFPP nr. 1, ndjekin kurse shumë kursantë, që janë persona me AK. Gjithashtu, DROFPP nr. 1 bashkëpunon dhe me shumë shoqata me të cilat kemi një bashkëpunim shumë të frytshëm të cilat kanë vlerësim maksimal për punën që bëhet në institucionin tonë në lidhje me trajtimin e këtyre personave. Më poshtë ju referojmë disa nga shoqatat që kemi bashkëpunim: - Shoqata: Ndhmoni Jetën; Ndhmë për Fëmijët; Qendra e Rehabilitimit Psikiatrik, Frederik Prenda dhe Karitasi. Konkretisht në qendër po zhvillojnë kurse si në: Kuzhinë, Saldim, Lllamarinist, Bojatisje automjeti, Berber dhe Kujdes për moshën e tretë.*

*Lidhur me planifikimin e fondeve të nevojshme për përshtatjen/aksesueshmërinë e godinës për personat me AK, kemi kërkuar realizimin e investimeve në këtë fushë dhe jemi në pritje për realizimin e këtyre investimeve të marra në konsideratë. Ju sqarojmë se Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive (AKPA), është institucioni përgjegjës për administrimin e IOAFP-se, e cila merret gjithashtu edhe me investimet për të garantuar cilësi në ofrimin e shërbimeve në këto institucione në përputhje me standardet e kërkuara”.*

*Me shkresën nr. 3082/2, datë 22.08.2022, AKPA, në mes të tjerash informoi Komisionerin se: “AKPA, si institucioni përgjegjës për administrimin e IOAFP-së, ka për detyrë të garantojë cilësinë në ofrimin e shërbimeve në këto institucione dhe vazhdon të ketë në fokus përmirësimin e infrastrukturës në përputhje me standardet e kërkuara. Konkretisht: Në të gjitha godinat me I (një) kat përdhe të institucioneve është mundësuar përshtatja fizike nëpërmjet ndërtimit të rampave për tu bërë e aksesueshme për kategoritë e PAK. Vlen për tu theksuar që për të gjitha shërbimet e punësimit dhe AFP-së të cilat kanë në plan të parë qytetarin, për të gjitha ambientet e brendshme të institucioneve publike është kryer një përshtatje fizike e godinave dhe të gjitha shërbimet janë të vendosura në katet e para.*

*Për sa i përket godinave shumë katëshe të institucioneve, në IOAFP, të rikonstruara është bërë përshtatja e objekteve ekzistuese nëpërmjet vendosjes së ashensorëve për të bërë të mundur aksesueshmërinë fizike për kategoritë e PAK. Ndërsa për sa i përket objekteve të pa rikonstruara po punohet për të kryer projektet përkatëse dhe për ti përshtatur me të njëjtat standarde si dhe për të gjetur mundësitë e financimit, të cilat mund të jenë ose nga buxheti i shtetit ose nga donatorë të ndryshëm.*

*Duam të sjellim në vëmendje që referuar vitit 2021 kanë ndjekur një kurs formimi profesional, 95 persona me AK në të gjithë vendin, ku 6 prej tyre në DROFPP nr. 1, Tiranë.*

*Gjithashtu, referuar të dhënave të marra nga shkresa Juaj, rezulton se S.C është banuese në Bashkinë Kamëz, kursi që kërkon të ndjekë është Web Desing. Bazuar në këto të dhëna do të shikohet mundësia e hapjes së këtij kursi në Qendrën Multifunkionale Kamëz, e cila është pranë*

*vendbanimit të saj, si dhe plotëson të gjitha kushtet infrastrukturore (ramp dhe ashensor). Theksojmë se, ndjekja e këtij kursi kërkon arsim të mesëm”.*

*Në përgjigje të shkresave të dërguara nga DROFPP nr. 1, Tiranë dhe AKPA, Fondacioni Së Bashku me e-mail-in datë 31.08.2022, ka informuar si vijon: “Sa i përket pretendimeve të DROFPP nr. 1, Tiranë mbi përgjigjen e stafit të kësaj Drejtorie ndaj kërkesës së S.C, ju bëjmë me dije se në receptionin e pritjes kanë qenë 2 punonjës, gjatë kohës kur S.C është paraqitur për të kërkuar ndjekjen e kursit profesional. Gjatë komunikimit verbal mes punonjësve është vënë re një sjellje jo korrekte dhe përçmuese, kjo sjellje ka ndikuar tek S.C për të mos vazhduar procedurat për nisjen e kursit, madje duke u ndjerë e ofenduar dhe jo e motivuar për të shkuar sërish në godinën ku do të duhej të ofrohej kursi.*

*Sa i përket pretendimeve për rampën e vendsour në godinën ku ushtron shërbimin DROFPP n.r.1 Tiranë, ju bëjmë me dije se është jashtë çdo standardi të kërkuar nga legjislacioni në fuqi, ku më konkretisht, VKM nr. 1503, datë 19.11.2008 “Për miratimin e rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuar”.*

*Në rastin konkret rampa e supozuar nga DROFPP nr. 1, Tiranë, nuk plotëson asnjë nga kushtet teknike duke qënë shumë e ngushtë dhe e papërdorshme dhe madje duke krijuar rrezikshmëri për personat me aftësi të kufizuar, në rast përdorimi të kësaj “rampe”.*

*Gjithashtu është e nevojshme të theksohet, se një mjedis nuk mund të quhet i aksesueshëm për PAK në rastet kur nuk ka banaqe të ulura për të pritur individët, nëse nuk ka tualet të përshtatshëm për PAK, po ashtu parking të dedikuar për PAK. Ndaj ju bëjmë me dije se mjediset e DROFPP nr. 1 Tiranë nuk disponojnë asnjë nga kërkesat e parashikuara nga ligji për të ofruar shërbim ndaj PAK, duke kryer diskriminim në ofrimin e kurseve të aftësive profesionale, pasi praktikisht e bën të pamundur aksueshmërinë e personave PAK në këto kurse, ashtu si në rastin e S.C.*

*Sa i përket pretendimit se S.C mund të ndjekë kurse të tjera profesionale që janë të aksesueshme në katin e parë të ndërtesës, shprehemi se kjo është e papranueshme dhe një tjetër formë diskriminimi. Askush nuk mund të imponojë zgjedhjen dhe dëshirat e individit për shkak të aftësisë fizike. S.C disponon të gjithë të drejtat, ashtu siç çdo qytetar i Republikës së Shqipërisë, për të zgjedhur kursin profesional që e sheh të përshtatshëm për tu zhvilluar profesionalisht. Është detyrë e institucionit shtetëror të ofrojë shërbimin sipas ligjit, në mënyrë të barabartë për të gjithë kërkuuesit, pa dallime, përfshirë edhe PAK”.*

- Me shkresën nr. 1135/4, datë 08.09.2022, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka kërkuar nga institucionet informacion dhe dokumentacion shtesë si më poshtëcitur:

Për Agjencinë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive.

- Dokumentacion mbi investimet e bëra gjatë 3-5 viteve të fundit, (në veçanti në DROFPP nr.1, Tiranë) për përmbojshjen e aspekteve që lidhen me përshtatjen dhe aksesueshmërinë

për personat me aftësi të kufizuara sipas legjislacionit në fuqi, të godinave njëkatëshe dhe shumëkatëshe në të cilat ofrohet formimi profesional (rampa, ashensorë, etj).

- Dokumentacion mbi planifikimin afatshkurtër dhe afatmesëm të projekteve dhe fondeve të nevojshme për përshtatjen/aksesueshmërinë e mjediseve të formimit profesional në varësinë e Agjencisë (në veçanti në DROFPP nr.1, Tiranë).
- Informacion se kur mund të bëhet i mundur ofrimi i kursit, të kompiuterit ose i gjuhës angleze, për ankuesen S.C në mjediset e Qendrës Multifunksionale Kamëz.

Për Drejtorinë Rajonale të Ofrimit të Formimit Profesional Publik nr. 1.

- Dokumentacion mbi përmbushjen e aspekteve që lidhen me aksesueshmërinë për personat me aftësi të kufizuara sipas legjislacionit në fuqi, të godinës së Drejtorisë (rampa, parkimi, etj).
- Dokumentacion mbi kurset e formimit profesional që ndjekin personat PAK (emrat e personave dhe kursin që ndjekin).
- Kopje të kërkesës/ave së bërë për realizimin e investimeve për përshtatjen e godinës për personat PAK.
- Informacion mbi kriteret/dokumentacionin që kërkohet për personat PAK, për tu regjistruar në kurse të ndryshme të formimit profesional. Kopje të aktit ligjor që rregullon këtë proces.

Me shkresën nr. 867, datë 19.09.2022, DROFPP nr. 1, Tiranë, në mes të tjerash informoi Komisionerin se: *“Sqarojmë se, në katin e parë është lehtësisht i aksesueshëm marrja e informacionit nga vetë personat PAK, pasi banaku është në parametrat dhe standartet të cilat ju përshtaten këtyre personave, po ashtu edhe rampa e instaluar në ambientet e godinës siguron lehtësi për këta persona.*

*Sqarojmë se, në mënyrë të vazhdueshme në takime të posaçme me eprorët kemi shprehur nevojën për plotësimin e kushteve të tjera fizike për ngjitjen në katet e mësipërme apo kritereve të tjera specifike që ndihmojnë personat PAK, por infrastruktura ekzistuese e institucionit e vështirëson ndërtimin e tyre.*

*Lidhur me kriteret që kërkohet për personat PAK për tu regjistruar në kurset e formimit profesional ne bazohemi në Udhëzimin nr. 14, datë 27.05.2021 “Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë së institucioneve të arsimit dhe formimit profesional, si dhe aspektet e menaxhimit të burimeve njerëzore, përbërjes së njësisë së zhvillimit të ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit”.*

*Bazuar në kurikulat e kurseve që ofrohen në formimin profesional niveli arsimor i kërkuar ndryshon sipas kurseve, në rastin specifik në kurrikulen e kursit “Web Design” citohet: “III. Pjesëmarrësit në Kursin për “Web Design” duhet të jenë mbi 18 vjeç, të kenë përfunduar arsimin e mesëm dhe të ketë njohuri në programet bazë kompjuterike”.*

Me shkresën nr. 3082/4, datë 19.09.2022, AKPA në mes të tjerash informoi Komisionerin se: *“Lidhur me investimet e bëra gjatë 3-5 viteve të fundit në DROFPP nr. 1, Tiranë, informojmë se gjatë periudhës së kërkuar nuk është bërë investim për rikonstrukcionin e godinës.*

*Përsa i përket dokumentacionit mbi planifikimin afatshkurtër dhe afatmesëm të projekteve dhe fondeve të nevojshme për përshtatjen/aksesueshmërinë e mjediseve të formimit profesional në varësinë e AKPA, informojmë se në zbatim të Strategjisë Kombëtare për Punësim dhe Aftësi dhe në përmbushje të objektivave të qeverisë shqiptare, po vijon reforma në fushën e arsimit dhe formimit profesional, një nga elementët në fokus të së cilës është synimi i AKPA-së për krijimin e një qendre model të formimit profesional në formën e një “Kampusi të Aftësive”, duke përshtatur dhe ndërhyrë në qendrat ekzistuese të formimit profesional. Ky Kampus parashikohet të ofrojë të gjithë infrastrukturën e nevojshme, duke përfshirë standardet për të mundësuar aksesin fizik për të gjitha kategoritë e PAK. Për sa më sipër, i jemi drejtuar me kërkesë ministrisë së linjës, për miratimin e ndërhyrjeve të propozuara dhe pritjet miratimi i projektit.*

*Ankuesja është banuese në Bashkinë Kamëz dhe kursi i formimit profesional “Web Desing” për të cilin S.C interesohet, ofrohet në Qendrën Multifunkcionale, Kamëz e cila është pranë vendbanimit të saj si dhe plotëson të gjitha kushtet infrastrukturore (rampa dhe ashensor). Për ndjekjen e këtij kursi S.C duhet të paraqitet pranë Qendrës Multifunkcionale, Kamëz së bashku me dokumentacionin e kërkuar në nenin 24 të Udhëzimit nr. 14, datë 27.5.2021.*

*Lidhur me ndjekjen e kursit profesional “Gjuhë e huaj Anglisht”, aktualisht ky kurs ofrohet në DROFPP nr. 4, Tiranë, i cili zhvillohet në katin e parë si dhe është i pajisur me rampë”.*

Në përgjigje të shkresave të dërguara nga DROFPP nr. 1, Tiranë dhe AKPA, Fondacioni Së Bashku me e-mail-in datë 27.09.2022, ka informuar si vijon: *“Qendra në fjalë nuk është hapur ende dhe kur të hapet ofron shërbime logopedie dhe fizioterapie për fëmijë me aftësi të kufizuara”.*

Mbështetur në nenin 33/8, të Ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, për shqyrtimin e mëtejshëm të ankesës, Komisioneri me shkresën nr. 1135/7, datë 18.10.2022 njoftoi, palët për zhvillimin e seancës dëgjimore me datë 26.10.2022, për të parashtruar dhe argumentuar në mënyrë të drejtpërdrejtë pretendimet e tyre, si dhe kërkoi kopje e dokumentacionit, si më poshtë:

Për Agjencinë Kombëtare të Punësimin dhe Aftësive.

- Argumentimin Tuaj, lidhur me pretendimet e subjektit ankues se, Qendra Multifunkcionale Kamëz nuk është hapur ende dhe nuk ofron kurse kompiuteri.
- Çfarë masash janë marrë nga AKPA për evidentimin e nevojave për aksesueshmërinë/përshtatshmërinë e qendrave të formimit profesional në varësinë e AKPA-së në të gjithë territorin e vendit? Kopje të dokumentacionit përkatës ku gjejnë pasqyrim masat e marra.

- A është bërë nga ana e AKPA një planifikim i fondeve të nevojshme për përshtatjen/aksesueshmërinë e qendrave të formimit profesional në varësinë e AKPA-së në të gjithë territorin e vendit, për personat PAK dhe afatet kohore për realizimin e këtyre investimeve? Nëse po, kopje të dokumentacionit ku janë bërë planifikimet përkatëse financiare dhe afatet kohore.
- Kopje të plotë të kërkesës që i keni drejtuar ministrisë së linjës, për miratimin e ndërhyrjeve të propozuara dhe përgjigjes së marrë.

Për Drejtorinë Rajonale të Ofrimit të Formimit Profesional Publik nr. 1.

- Dokumentacion ligjor mbi përmbushjen e aspekteve që lidhen me aksesueshmërinë për personat me aftësi të kufizuara sipas VKM-së nr. 1503, datë 19.11.2008 *“Për miratimin e rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara”, të godinës së DROFPP nr.1 (rampa, parkimi, etj).*
- Kopje të kërkesës/ave (shkresë ose email) së bërë për realizimin e investimeve për përshtatjen e godinës për personat PAK.

Bazuar në nenin 80/1/b të Kodit të Procedurave Administrative dhe Rregullores së Brendshme të Komisionerit, seanca dëgjimore u regjistrua audio dhe përmbajtja e saj do të përdoret si provë gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës.

Seanca u zhvillua në datë 26.10.2022 dhe morën pjesë vetëm përfaqësuesit me autorizim të AKPA<sup>5</sup> dhe Drejtorja dhe Juristja e DROFPP Tiranë. Subjekti ankues i njoftuar për të marrë pjesë në seancën dëgjimore, Fondacioni Së Bashku nuk u paraqit në seancë, pavarësisht se kishte marrë njoftim nëpërmjet shërbimit postar<sup>6</sup>.

Përfaqësuesit e AKPA-së depozituan gjatë seancës dëgjimore, shkresën nr. 3440, datë 01.09.2022, drejtuar MFE-së *“Kërkesë për rishikimin e tavanit për zërin e investimeve për vitin 2023-2024”*, në të cilën kërkonin shtimin e tavanit buxhetor për shpenzime kapitale për ndërtimin e një hapësire të re shumë funksionale në mjediset e Drejtorisë Rajonale të Formimit Profesional Publik nr. 4, Tiranë.

Gjatë seancës dëgjimore, AKPA i qëndroi të njëjtave parashtrime që kishte bërë të njohura gjatë komunikimit shkresor me KMD-në dhe informoi<sup>7</sup> se: *“Qendra Multifunkionale Kamëz funksionon pranë shkollës së mesme profesionale Kamëz dhe ka kapacitetet profesionale dhe infrastrukturore për të ofruar kursin “Web Desing”, por për këtë kërkohet që të regjistrohen një grup prej 7 personash për të hapur kursin. Duke qenë se jemi në fazë tranzitore, lidhur me optimizimin e arsimit profesional, do të ketë një bashkim të arsimit profesional me kurset afatshkurtra dhe do të ndodhë një ndërthurje e këtyre dy formave të arsimit profesional. Për momentin nuk mund të ketë një plan afatshkurtër për investime në infrastrukturën e godinës, pasi*

<sup>5</sup> Referuar autorizimit nr. 3082/7, datë 24.10.2022 të AKPA.

<sup>6</sup> Referuar dokumentit: Lajmërim marrje poste, nr. RR232218605AA.

<sup>7</sup> Referuar deklaratimeve të bëra gjatë seancës dëgjimore, min 41.30 e në vijim.

*do të shikohet se si do sistemohet njëherë i gjithë ndryshimi që do ndodhë. Vitin e ardhshëm pasi të shikohet optimizimi do shikohet dhe mundësia e investimit në ndërtesa”.*

Gjatë seancës dëgjimore, DROFPP nr. 1, Tiranë, nuk depozitoi një dokument ligjor mbi përmbushjen e aspekteve që lidhen me aksesueshmërinë për personat me AK sipas VKM-së nr. 1503/2008, por i qëndroi të njëjtave parashtrime që kishte bërë të njohura gjatë komunikimit shkresor me KMD-në dhe informoi<sup>8</sup> se: *“Ndërtesa është e vjetër dhe nuk mund të përshtatet me ashensor. Investimi i fundit në godinën e DROFPP nr. 1, Tiranë është bërë në vitin 2007. Rampa është ndërtuar më përpara se 7 vite që H.M ishte drejtor. DROFPP nr. 1, Tiranë ofron parkim për personat me AK në oborrin pas godinës, por nuk ka sinjalistikë për këtë qëllim. Të gjitha standardet që kërkohen kanë të bëjnë me investime të cilat bëhen nga AKPA dhe jo nga DROFPP nr. 1, Tiranë”.*

Në vijim të seancës dëgjimore, AKPA me shkresën nr. 3082/8, datë 10.11.2022, informoi Komisionerin si më poshtë: *“Strategjia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive (2019-2022), parashikon optimizimin e ofruesve të AFP-së në nivel individual dhe rrjeti, për të siguruar një ofertë cilësore dhe të larmishme. Në këtë kuadër, në çdo qark do të kemi ndryshime infrastrukturore të IOAFP-ve, ku jo vetëm Drejtoritë Rajonale të Ofritit dhe Formimit Profesional por dhe Shkollat e Mesme Profesionale, përveç arsimit të mesëm profesional do të ofrojnë dhe kurse afatshkurtra të formimit profesional, duke u kthyer kështu në qendra shumëfunksionale.*

*Planifikimi afatmesëm dhe afatgjatë në lidhje me investimet të cilat do të kryhen përfshin të gjithë institucionet ofruese të AFP-ve të cilat do të ofrojnë kurse të formimit profesional.*

*Gjatë periudhës 2019-2022 janë rikonstruktuar 6 shkolla të mesme profesionale, duke plotësuar të gjitha kushtet infrastrukturore, përfshirë aksesin për personat me aftësi të kufizuara. Gjatë vitit 2023-2024 kanë filluar apo janë në proces rikonstruksioni 5 shkolla të mesme profesionale.*

*Ju sqarojmë se MFE është Autoriteti Kontraktor i cili planifikon dhe zhvillon procedurat e prokurimit. Duke qenë se në përfundim të procesit të optimizimit në këto godina do të ofrohen dhe kurse afatshkurtra të formimit profesional, këto investime në infrastrukturën e shkollave profesionale konsiderohen si investime dhe në funksion të ofritit të formimit profesional. Për sa i përket evidentimit të situatës aktuale lidhur me aksesueshmërinë/përshtatshmërinë e qendrave të formimit profesional në të gjithë territorin e vendit, tabela më poshtë pasqyron inventarin e këtyre godinave lidhur me sa më sipër:*

DROFPP	Ashensor	Rampa	Nr. i rampave	Kate
DROFPP nr. 1 Tiranë		Po	1	3
DROFPP Korçë	Po			2
DROFPP Durrës				2

<sup>8</sup> Referuar deklarimeve të bëra gjatë seancës dëgjimore, min 10.00 e në vijim.

DROFPP nr. 4 Tiranë		Po	2	2
DROFPP Lëvizëse				3
DROFPP Elbasan		Po	1	2
DROFPP Fier		Po	1	2
DROFPP Shkodër				2
DROFPP Gjirokastrë				3
DROFPP Vlorë	Po			3
QSHF Kamëz	Po (2)	Po	2	4

### III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

Ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 1 sipërcituar dhe nenin 3/1, parashikojnë se: “*Diskriminim’ është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi*”.

Gjatë shqyrtimit të ankesës dhe ndjekjes së procedurës hetimore, Komisioneri në përputhje me ligjin ka kërkuar informacionin e nevojshëm dhe dokumentacionin mbështetës, lidhur me rastin e subjektit ankues, në mënyrë që të mund të vlerësonte me objektivitet pretendimin e tij për trajtim të pa drejtë dhe diskriminues.

Komisioneri ka përmbushur kërkesat e parashikuara në Kodin e Procedurës Administrative, edhe sa i takon dhënies së ndihmës efektive, gjë e cila është përcaktuar në nenin 10, të tij: “*Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur. Ai i informon palët mbi të drejtat dhe detyrimet e tyre, përfshirë të gjithë informacionin e lidhur me procedurën dhe i paralajmëron ato për pasojat ligjore të veprimeve ose mosveprimeve të tyre*”.

LMD, i ndryshuar, në nenin 32, pikën 2, të tij ka përcaktuar qartë këtë detyrim, duke cituar se: “*Të gjitha institucionet publike dhe subjektet private janë të detyruara të mbështesin Komisionerin, duke i dhënë informacionin që i nevojitet dhe duke i garantuar aksesin në informacionin në përmbushjen e detyrave të tij*”.

#### A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë.

Komisioneri ka shqyrtuar çështjen bazuar në situatën e konstatuar, provat dhe informacionin e administruar gjatë procedurës administrative të zhvilluar.

Arsimi dhe formimi profesional në Republikën e Shqipërisë rregullohen sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 15, datë 16.02.2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë” (në vijim Ligji nr.15/2017). Referuar nenit 2/ç, qëllimi i këtij ligji është që të

garantojë mundësi të barabarta për të gjithë individët që duan të ndjekin studimet në fushën e Arsimit dhe Formimit Profesional (AFP). Në nenin 5/a, të këtij ligji përcaktohet se: “Sistemi i AFP-së bazohet në këto parime themelore: “a) Parimi i gjithëpërfshirjes: Sistemi i AFP-së ofron mundësi arsimimi dhe formimi profesional për të gjithë, pa asnjë diskriminim”, ndërsa në pikën 5/d përcaktohet se: “Parimi i garantimit të pjesëmarrjes: Sistemi i AFP-së krijon kushtet financiare, fizike dhe shoqërore për individët për të përfitur nga mundësitë e të nxënës gjatë gjithë jetës”. Në nenin 7 të këtij ligji, Ministria përgjegjëse për AFP ka ndër të tjera këto kompetenca: “ç) siguron burimet e nevojshme njerëzore, financiare e logjistike për funksionimin e AFP-së”. Në nenin 30/1/a të këtij ligji përcaktohet se: “Arsimi dhe formimi profesional publik financohen nga: a) buxheti i shtetit; b)...c)...ç)...”. Në nenin 32/1 përcaktohet se: “1. Alokimi i Buxhetit të Shtetit për ofruesit publikë të arsimit dhe formimit profesional bëhet bazuar në parashikimet për shpenzimet e personelit, përfshirë pagat, kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore, shpërblimet për performancë të mirë dhe zhvillimin e vazhdueshëm profesional, shpenzimet operative përfshirë mallrat e konsumit, riparimet, shpenzimet e tjera operative për zhvillimin e praktikës dhe teorisë profesionale, aktivitete ekstrakurrikulare dhe funksionimin e institucionit, si edhe investimet, përfshirë ndërtimin dhe rindërtimin e ndërtesave, blerjen e pajisjeve të mëdha dhe veprimtari të tjera të lidhura me to””.

Referuar Vendimit nr. 110, datë 02.03.2022 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë”, fusha e arsimit dhe formimit profesional është nën përgjegjësinë e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, e cila është përgjegjëse për zhvillimin e politikave shtetërore për arsimin dhe formimin profesional.

Në nenin 12, pika 1 dhe pika 2/a, të ligjit nr. 15/2017, përcaktohet: “1. AFP-ja ofrohet nga institucionet publike dhe private. 2. Institucionet ofruese të AFP-së janë: c) qendrat e formimit profesional”. Sa më sipër, DROFPP nr. 1, Tiranë, është një qendër e formimit profesional dhe referuar nenit 12/2/c, të Ligjit nr. 15/2017, ajo konsiderohet sipas këtij ligji, ofrues publik i AFP-së.

Referuar nenit 6/1, të Udhëzimit nr. 14, datë 27.05.2021 të MFE “Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë së institucioneve të arsimit dhe formimit profesional, si dhe aspektet e menaxhimit të burimeve njerëzore, përbërjes së njësisë së zhvillimit të ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit”, përcaktohet se: “Ofruesit e AFP-së janë institucione publike ose private, në varësi të ministrisë përgjegjëse për AFP-në, në menaxhimin e AKPA”.

Për sa më sipër, rezulton se Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe AKPA janë autoritetet përgjegjëse në fushën e arsimit dhe formimit profesional, në institucionet publike që ofrojnë këtë shërbim. Përgjegjësitë e këtyre institucioneve lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me financimin e investimeve në ndërtimin dhe rindërtimin e objekteve në të cilat ofrohet formimi profesional dhe në rastin konkret, në godinën e DROFPP nr. 1, Tiranë.

Lidhur me pretendimin e ankueses për përdorimin e një gjuhe fyese/tallëse nga ana e punonjësve të DROFPP nr. 1, Tiranë, Komisioneri vlerëson se pretendimi i ngritur nuk është i mbështetur në fakte, por ngelet në kuadër të deklarimeve dhe i pambështetur në prova.

Për të marrë informacion dhe për të shqyrtuar pretendimet e ngritura nga pala ankuese lidhur me mosofrimin e kursit të kërkuar nga ankuesja si rezultat i mungesës së aksesueshmërisë në godinën e DROFPP nr. 1, Tiranë, Komisioneri i'u drejtuar AKPA-së dhe DROFPP nr. 1, Tiranë, në cilësinë e subjektit kundër të cilit është paraqitur ankesa objekt shqyrtimi, duke kërkuar informacion nëse godina e DROFPP nr. 1, Tiranë, plotësonte standardet e aksesueshmërisë, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

Nga informacioni i administruar<sup>9</sup> rezulton se, godina e DROFPP nr. 1, Tiranë, që përbën dhe objektin kryesor të ankesës, është nën menaxhimin e AKPA, por investimet në këtë godinë bëhen me fonde të MFE-së, sipas legjislacionit që do paraqitet në vijim.

Nga pamjet fotografike të mjediseve të jashtme dhe të brendshme të godinës objekt shqyrtimi, rezulton se rampa, mjediset e brendshme dhe parkimi, nuk plotësojnë standardet e parashikuara në VKM-në nr. 1503/2008.

Gjatë shqyrtimit të ankesës, DROFPP nr. 1, Tiranë deklaroi se godina nuk është e aksesueshme në katin e 2-të dhe të 3-të, për arsye se nuk ka ashensor dhe se parkimi për personat me AK ofrohet në mjediset e jashtme por nuk ka sinjalistikë, horizontale dhe vertikale sipas legjislacionit që do shtjellohet më poshtë.

DROFPP nr. 1, Tiranë nuk dërgoi asnjë dokumentacion ligjor apo informacion të detajuar në lidhje me përmbushjen e kriterëve dhe parashikimeve në lidhje me sigurimin e aksesueshmërisë të parashikuara nga VKM-të nr. 1503/2008 dhe nr. 1074, datë 23.12.2015 apo ndonjë planifikim për plotësimin e tyre në të ardhmen. Sipas DROFPP nr. 1, Tiranë, në vitin 2007 është bërë investimi i fundit në godinë, por nuk rezulton të jenë kryer investime me qëllim sigurimin e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara, pasi dhe standardet e aksesueshmërisë janë miratuar në vitin 2008, ndërsa masat për mënjanimin e pengesave në infrastrukturë janë miratuar në vitin 2015.

### **Kuadri ligjor i zbatueshëm.**

Me ligjin nr. 108/2012 *“Për Ratifikimin e Konventës së OKB-së “Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”<sup>10</sup>*, Shqipëria ka ratifikuar Konventën e OKB-së *“Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”<sup>11</sup>*. Bazuar në nenin 116, të Kushtetutës, ky akt ndërkombëtar i të drejtave të njeriut jo vetëm që bëhet pjesë e të drejtës së brendshme e detyrueshme për t’u zbatuar, por duke patur edhe përparësi ndaj ligjeve të tjera.

<sup>9</sup> Referuar fotografive të dërguara nga DROFPP nr. 1 dhe deklarimeve të bëra gjatë seancës dëgjimore.

<sup>10</sup> Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën KDPAK.

<sup>11</sup> Ratifikuar me ligjin nr. 108/2012 *“Për Ratifikimin e Konventës së OKB-së “Për të Drejtat e Personave me AK”*.

KDPAK përfaqëson standardin më të lartë të mbrojtjes së të drejtave të personave me aftësi të kufizuara. Qëllimi i kësaj Konvente është të promovojë, mbrojë dhe sigurojë që të gjithë personat me aftësi të kufizuar të gëzojnë plotësisht dhe në mënyrë të barabartë të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të promovojë respektin e dinjitetin e tyre të lindur (neni 1).

Konventa nuk jep një përkufizim të aftësisë së kufizuar, por pranon se aftësia e kufizuar është një koncept evolues dhe se aftësia e kufizuar rezulton nga ndërveprimi ndërmjet personave me dëmtime dhe barrierave/pengesave të qëndrimit/mentalitetit dhe ambientit që pengojnë pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe efektive në shoqëri në nivel të barabartë me të tjerët (Preambula e KDPAK, gërma “e”). Rrjedhimisht në qendër të vëmendjes nuk duhet të jetë paaftësia/paaftësitë e mundshme, por kufijtë që ngre shoqëria, duke penguar gëzimin e të drejtave. Nga ana tjetër KDPAK pranon diversitetin e personave me aftësi të kufizuara.

Me qëllim që të bëhet e mundur që të gjithë personat me aftësi të kufizuar të mund jetojnë në mënyrë të pavarur dhe të marrin pjesë plotësisht në të gjitha aspektet e jetës, shtetet duhet të marrin masat e duhura për të siguruar akses për personat me aftësi të kufizuar, në baza të barabarta me të tjerët, në ambientet fizike, transport, informacion dhe komunikim, përfshirë dhe teknologjitë dhe sistemet e informacionit dhe komunikimit, si dhe në mjete apo shërbime të tjera të hapura apo të siguruara për publikun, si në zonat urbane dhe ato rurale. Këto masa, të cilat duhet të përfshijnë identifikimin dhe eliminimin e pengesave dhe barrierave për mundësimin, zbatohen ndër të tjera për: a) ndërtesa, rrugë, transport dhe mjete të tjera në ambiente të brendshme apo të jashtme, përfshirë shkollat, strehimin, shërbime mjekësore apo vendet e punës; (neni 9/1 KDPAK).

Aksesueshmëria ose e thënë ndryshe heqja e pengesave/barrierave, është një parakusht që personat me aftësi të kufizuara të marrin pjesë në baza të barabarta me të tjerët në shoqëri, për të jetuar në mënyrë të pavarur, për të gëzuar gjithë të drejtat dhe liritë e parashikuara. Për rrjedhojë, aksesueshmëria është ngushtësisht e lidhur me barazinë dhe mosdiskriminimin e personave me aftësi të kufizuara. Aksesueshmëria duhet të sigurohet për të gjithë personat me aftësi të kufizuara, pavarësisht nga lloji i aftësisë së kufizuar. Për rëndësinë që aksesueshmëria paraqet, parashikohet nga KDPAK si një e drejtë më vete në nenin 9, por edhe si një nga parimet themelore që përshkon të gjithë Konventën, sipas nenit 3.

Në pikën 2, të nenit 9, të KDPAK, parashikohet se: “2. Shtetet palë duhet gjithashtu të marrin masat e duhura: a) për të zhvilluar, shpallur dhe monitoruar implementimin e udhëzimeve dhe standardeve minimale për mundësimin e mjeteve dhe shërbimeve të hapura apo të siguruara për publikun;...”

Në frymën e Konventës, është miratuar, ligji 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara” (në vijim ligji nr. 93/2014). Në nenin 3, pika 9, të ligjit të sipërcituar, përcaktohet se: “9. “Persona me aftësi të kufizuara” janë individët që kanë dëmtime afatgjata fizike, mendore, intelektuale ose ndijore, dëmtime të cilat, në bashkëveprim me

*pengesat e ndryshme, përfshirë ato mjedisore dhe të qëndrimit, mund të pengojnë pjesëmarrjen e plotë dhe efikase të këtyre personave në shoqëri, në kushte të barabarta me të tjerët”.*

Në nenin 3, pika 1, të ligjit nr. 93/2014, përcaktohet: “Aksesueshmëri” është mënjanimi i pengesave të të gjitha llojeve”. Më tej në pikën 3, të këtij neni parashikohet se: “ 3. “Pengesat” nënkupton: a) pengesat sociale, veçanërisht qëndrimet, stereotipet e sjelljen tutelore; b) pengesat mjedisore, përfshirë vështirësitë në komunikim që kanë personat me dëmtime ndijore, veçanërisht ata me dëmtime në shikim dhe dëgjim, ata për të cilët komunikimi verbal është i kufizuar ose i pamundur e personat që kërkojnë formate të thjeshta për t’u lexuar dhe për t’u kuptuar; c) pengesat infrastrukturore, përfshirë ato në banesa, hapësira dhe shërbime publike; ç) pengesat institucionale, përfshirë ato në legjislacion dhe politika”.

Në përputhje me qasjen e KDPAK edhe ky ligj sanksionon se garantimi i aksesueshmërisë nëpërmjet mënjanimit të pengesave të të gjitha llojeve është një nga parimet e këtij ligji (neni 3/ç) dhe se jetesa e pavarur e personave me aftësi të kufizuar mund të sigurohet nëpërmjet garantimit të aksesueshmërisë, përfshirë aksesin në arsim.

Sipas germës “b”, të pikës 2, të nenit 5, të ligjit nr. 93/2014, parashikohet: “2. *Politikat shtetërore mbështetin personat me aftësi të kufizuara që të kenë akses në të gjitha sferat e jetës e, ndër të tjera, të kenë akses përkatësisht: ..... b) në shkollat e zakonshme dhe të studiojnë në shkollën për të cilën dëshirojnë; ç) në qendra kulturore, sportive dhe qendra të tjera publike;...*”. Në nenin 6/2/b) përcaktohet se: “*Shërbimet që mundësojnë jetesën e pavarur kanë minimalisht karakteristikat e mëposhtme: b) mbulojnë në mënyrë gjithëpërfshirëse të gjitha sferat e jetës, përfshirë sferën e punës, arsimit dhe aktiviteteve shoqërore, profesionale dhe të kohës së lirë, si dhe të gjitha dëmtimet e nevojat për ndihmë që rrjedhin nga dëmtimi/aftësia e kufizuar”.*

Për mënjanimin e pengesave mjedisore dhe infrastrukturore, Këshilli i Ministrave ka miratuar Vendimin nr. 1074, datë 23.12.2015 “*Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara*” (në vijim VKM nr. 1074/2015). Ky vendim përcakton masat për zbatimin dhe unifikimin e rregullave, në bazë të të cilave mënjanohen pengesat mjedisore dhe infrastrukturore për të bërë të mundur aksesin në strehim, transport, shëndetësi, kujdes social, arsimim, punësim dhe shërbime për personat me aftësi të kufizuara. Sipas këtij vendimi, janë pengesa infrastrukturore: a) pengesat fizike si burim vështirësish për lëvizjen e kujtudo dhe në mënyrë të veçantë të atyre që, për çfarëdolloj arsyeje, kanë një aftësi lëvizëse të kufizuar, të përhershme ose të përkohshme; b) pengesat që kufizojnë ose pengojnë këdo në përdorimin komod dhe të sigurt të hapësirave, pajisjeve e të pjesëve përbërëse; c) mungesa e mjeteve dhe e sinjalizimeve që lejojnë orientimin dhe njohjen e vendeve e të burimeve të rrezikut për këdo dhe, në veçanti, për personat me shikim apo dëgjim të kufizuar (Kreu I, pika 3). Ky vendim është i detyrueshëm si ndaj sektorit publik ashtu edhe atij privat dhe përfshin të gjitha ndërtesat e reja ashtu edhe ato ekzistuese, e në mënyrë të veçantë ato mjedise ku ofrohen shërbime publike. (Kreu I, pika 4).

Sipas pikës 2, të kreut 2, të kësaj VKM-je, çdo kërkesë teknike për përshtatshmërinë e objekteve të reja dhe atyre ekzistuese, parqeve, shesheve dhe rrugëve zbatohet sipas dispozitave të parashikuara në vendimin nr. 1503, datë 19.11.2008, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara” (në vijim VKM nr. 1503/2008). Ndër të tjera, në këtë rregullore parashikohet sa më poshtë vijon:

#### *“PJESA I*

*Zbatimi i rregullave për eliminimin e barrierave arkitektonike në banesat, hapësirat dhe shërbimet publike.*

#### *Kreu I*

##### *Të përgjithshme*

#### *Neni 1*

*Objekti, qëllimi dhe fusha e aplikimit*

- 1. Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i kërkesave teknike për eliminimin e pengesave që përcaktohen si “barriera arkitektonike”.*
- 2. Kjo rregullore ka për qëllim zbatimin e rregullave për eliminimin e barrierave arkitektonike në banesat, hapësirat dhe shërbimet publike.*
- 3. Fusha e aplikimit të saj shtrihet në:*
  - të gjitha objektet publike të reja të ndërtuara me fondet e buxhetit të shtetit apo private si dhe në objektet private, që ndërtohen në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë;*
  - godinat dhe hapësirat publike, ndërtimet e reja me karakter të përkohshëm, ose në ato ekzistuese nëse do t’i nënshtrohen rikonstruksionit;*
  - ndërtesat dhe hapësirat publike që i nënshtrohen çfarëdolloj ndërhyrjeje ndërtimi që ka të bëjë me heqjen e kufizimit të mundësisë së pamjes dhe fushëpamjes, që të paktën, qoftë edhe pjesërisht, është pjesë e ndërhyrjes;*
  - ndërtesat dhe hapësirat publike që janë, tërësisht ose pjesërisht, objekt i ndryshimit të destinacionit nëse do të jetë në përdorim publik, si edhe për shërbime të veçanta për përdorim publik.*

#### *Neni 2*

*Përshtatja e objekteve ekzistuese*

- 1. Në ndërtesat dhe hapësirat publike ekzistuese, edhe pse nuk janë objekt ristrukturimi ose riorganizimi funksional, duhet të evidentohen dhe të llogariten të gjitha mundësitë për përshtatje, të cilat mund të përmirësojnë shfrytëzimin në bazë të kërkesave që janë në këtë rregullore.*
- 2. Çdo ndërtesë duhet të pajiset, nën kujdesin e administratorit publik apo privat të ndërtesës, me një sistem thirrjesh që të aktivizojë një shërbim ndihme në mënyrë të tillë që t’u lejojë personave me aftësi të kufizuara lëvizjen ose ndijimin e shërbimit me zë.*
- 3. Në objektet e banimit publike/private dhe në banesa vetjake, përfshi edhe ato të hapura për publikun, aplikohen rregullat dhe standardet e përcaktuara në këtë rregullore.*

4. Nuk mund të ofrohen kontribute ose lehtësime nga ana e shtetit dhe e enteve të tjera publike për realizimin e punimeve publike ose të shërbimeve publike në kundërshtim me këto rregulla dhe standarde.

Neni 3

1. Barrierat arkitektonike janë:

- a) pengesat fizike si burim vështirësish për lëvizjen e kujtudo dhe në mënyrë të veçantë të atyre që, për çfarëdolloj arsyeje, kanë një aftësi lëvizëse të kufizuar të përhershme ose të përkohshme;
- b) pengesat që kufizojnë ose pengojnë këdo në përdorimin komod dhe të sigurt të hapësirave, pajisjeve dhe pjesëve përbërëse;
- c) mungesat e mjeteve dhe e sinjalizimeve që lejojnë orientimin dhe njohjen e vendeve dhe të burimeve të rrezikut për këdo dhe në veçanti për personat me shikim apo dëgjim të kufizuar.

8. Eliminimi i barrierave - është rezultat i aplikimit të zgjedhjes teknike në projektim dhe ndërtim të objektit me të cilat PAK-ja siguron lëvizjen pa pengesë, qëndrimin dhe kryerjen e punëve në to në të njëjtin nivel sikurse personat e tjerë.

19. Përpunimi relievor - është përpunimi përfundimtar me reliev i sipërfaqes së ecjes.

20. Vija relievore drejtuese - është përpunimi me reliev i sipërfaqes së ecjes e dedikuar për drejtim të lëvizjes së personave që nuk shikojnë dhe/ose me shikim të dobësuar, e cila në fund të rrugës dhe në vendin e ndërrimit të drejtimit të lëvizjes përcakton atë me ndërrimin e strukturës relievore me gjerësi së paku 40 cm.

21. Vija relievore paralajmëruese - është përpunim me reliev i sipërfaqes së ecjes, e cila vendoset me qëllim të paralajmërimit të personave që nuk shohin dhe/ose me shikim të dobësuar për rrezikun nga komunikacioni.

22. Fusha relievore paralajmëruese - është përpunimi me reliev i sipërfaqes së ecjes, e cila shërben për paralajmërim të personave që nuk shikojnë dhe/ose me shikim të dobësuar të ndryshimit të nivelit të lëvizjes.”

Në nenet 18 dhe 19, të pjesës së parë të rregullores, parashikohet se, hapësirat e jashtme të ndërtesës dhe elementet përbërëse të tyre, si dhe sinjalistika, duhet të jetë e përshtatur sipas specifikimeve të parashikuara nga dispozitat respektive të rregullores (pikat 2 të nenit 4 dhe standardet e pikës 2 të nenit 8 të pjesës së dytë të kësaj rregulloreje dhe rregullat e pikës 3 të nenit 4 të pjesës së dytë të kësaj rregulloreje), në mënyrë që të mund të jenë të arritshme nga ana e personave me aftësi të kufizuara.

Në nenin 25, të pjesës së parë të rregullores së sipërpërmendur, përcaktohet : “1. Ndërtesat e institucioneve parashkolllore, shkolllore, përfshirë universitetet dhe institucione të tjera me interes shoqëror në sektorin e arsimit duhet të sigurojnë përdorimin e tyre edhe për nxënës me aftësi të kufizuar lëvizëse. 2. Strukturat e brendshme duhet të kenë karakteristikat për të cilat

flitet në nenet 9, 17, 19, dhe strukturat e jashtme ato për të cilat flitet në nenin 12 të pjesës së parë të kësaj rregullore. 3. Mobilimi, mjetet ndihmëse didaktike dhe pajisjet e nevojshme për të siguruar zhvillimin e aktiviteteve didaktike duhet të kenë karakteristika të veçanta për personat me aftësi të kufizuara (banka, karrige, makina shkrimi, materiali Braille, dhoma zhveshjeje, etj). 4. Në rastin e ndërtesave shkollë me shumë kate pa ashensor, klasa që frekuentohet nga një nxënës me aftësi të kufizuara duhet të jetë e vendosur në katin përdhe e arritshme nëpërmjet një kalimi të vazhdueshëm horizontal dhe me pjerrësi në pjesë të nevojshme të saj”.

Sipas nenit 9, të pjesës së parë të rregullores, përcaktohet rregulla të posaçme për shkallët dhe platformat, të cilat duhet të jenë në përputhje me kriteret e përcaktuara nga neni 4, pikat 1.10 dhe 1.11 dhe pikat 2.10, 2.11 dhe 3.3, të nenit 8, të pjesës së dytë të rregullores.

Sipas neni 17, i cili ka të bëjë me njësitë e mjedisit dhe përbërësit e tyre si dyert, dyshemetë, kornizat e jashtme, orenditë fikse, terminalet e impianteve, shërbimet higjienike, ballkonet, tarracat, kalimet horizontale, shkallët, platformat, ashensorët, shkallët e shërbimit, platformat ngritëse, etj, vlejnë rregullat e përcaktuara në pikën 1 të nenit 4 dhe standardet e përcaktuara në pikën 2 të nenit 8 të pjesës së dytë të kësaj rregulloreje.

Në pjesën e dytë të rregullores, përcaktohen rregullat teknike dhe standardet për garantimin e mundësisë së hyrjes, përshtatshmërisë dhe fushpamjes në ndërtesa. Disa nga parashikimet e kësaj pjesë të rregullores janë si më poshtë:

#### *“Kreu I*

##### *Të Përgjithshme*

#### *Neni 1*

##### *Fusha e aplikimit*

*Rregullat e përfshira më poshtë aplikohen në:*

- ndërtesat private që ndërtohen të reja, rezidenciale ose jo;
- ndërtesat rezidenciale publike të financuara nga buxheti i shtetit, që ndërtohen të reja;
- ristrukturimet e ndërtesave private dhe publike;
- hapësirat e jashtme të ndërtesave të lartpërmendura në zonat e përcaktuara.

#### *Kreu III*

##### *Zbatimi i rregullave*

#### *Neni 7*

##### *Zbatimi dhe shmangia nga rregullat*

*1. Standardet që përmban neni 8 në pjesën e dytë të kësaj rregulloreje, janë të detyrueshme për t’u zbatuar. Zgjidhjet teknike që përcaktohen në nenin 9 të pjesës së dytë të kësaj rregulloreje edhe pse nuk mbështeten në standardet e dhëna në këtë rregullore, janë të pranueshme nëse u përgjigjen kriterëve të projekteve të cilat plotësojnë rregullat nëpërmjet reduktimit të dimensioneve me zgjidhje të veçanta hapësinore ose teknologjike.*

2. Në projekt propozohen zgjidhje alternative për specifikimet dhe zgjidhjet teknike, që i përgjigjen kriterëve të projektimit. Në këtë rast çdo ndryshim duhet shoqëruar nga relacioni i ilustruar me grafikët e nevojshëm për të treguar alternativën e propozuar dhe ekuivalentin ose cilësinë më të mirë të rezultateve që rrjedhin nga zbatimi i tyre.

3. Përputhshmëria e projektit me rregullat dhe standardet e dhëna në rregulloren e miratuar me këtë vendim dhe përshtatshmëria e zgjidhjeve të mundshme alternative certifikohen nga profesionistë të përgatitur pranë zyrave të kontrollit të projektit.

4. Rregullat dhe standardet e këtij vendimi, janë të shmangshme vetëm për ndërtesat ose pjesë të tyre, të cilat në respektim të rregullave teknike specifike, nuk mund të realizohen pa pengesa arkitektonike, ose për vende të posaçme teknike në të cilat hyrja u rezervohet vetëm personave të specializuar.

5. Në ndërhyrjet e ristrukturimit, lejohen shmangiet në rastin e pamundësisë teknike në lidhje me elementet strukturore dhe të impianteve, të cilat vërtetohen paraprakisht. Shmangiet lejohen vetëm nga autoritetet kompetente, përcaktuar në pikën 3 të këtij neni.”

Në nenin 4, të pjesës së dytë të rregullores, përcaktohen në mënyrë të detajuar kriteret e projektimit për arritshmërinë, për njësitë e mjedisit dhe përbërësit e tij si dhe hapësirat e jashtme. Ndërsa në Kreun IV, të pjesës së dytë, të rregullores, përcaktohen standardet dhe zgjidhjet teknike të detyrueshme për t’u zbatuar me qëllim për të garantuar mundësinë e hyrjes dhe përshtatshmërinë e ndërtesave nga ana e personave me aftësi të kufizuara. Konkretisht në nenin 8, të kësaj rregulloreje, përcaktohen në mënyrë të detajuar standardet funksionale dhe të përmasave në ndërtesa, të detyrueshme për t’u respektuar.

Në nenin 9, të pjesës së dytë të rregullores, trajtohen kriteret në lidhje me platformat ngritëse vertikale dhe të pjerrëta palosëse, që përdoren si element për nevojat e arritshmërisë në nivele me lartësi të ndryshme më të mëdha se 120 cm në hapësirat e jashtme dhe të brendshme, kur nuk ka zgjidhje me ashensorë të përshtatur ose elemente të tjerë të përshtatur. Kriteret e posaçme parashikohen edhe për dhomat, klasat dhe hapësirat e punës, të cilat gjejnë pasqyrim në nenin 10, të pjesës së dytë të rregullores. Sipas nenit 18, të pjesës së dytë, të rregullores, ndërtesat duhet të jenë të pajisura me një plan orientues sipas kriterëve të posaçme të parashikuara nga kjo dispozitë.

Kreu VI, i pjesës së dytë, të rregullores, përmban rregullime lidhur me realizimin e rregullave për përshtatjen dhe shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara. Në nenin 30, të këtij kreu, parashikohet respektimi i elementëve lidhur me përshtatjen, sipas natyrës dhe qëllimit të objektit/ndërtesës. Në pikën 2, të nenit 30, përcaktohet ndër të tjera se:

“ Neni 30

*Respektimi i elementeve të përshtatjes sipas natyrës dhe qëllimit të objektit.*

*Ndërtesat publike, me destinacion për ushtrimin e një veprimtarie prodhuese, duhet të projektohen dhe të realizohen duke respektuar rregullat e standardet e përshtatjes të dhëna në*

*pjesën e dytë të kësaj rregulloreje, në përputhje me qëllimin për të cilin ato ndërtohen sipas neneve përkatëse.*

.....

*7. Ndërtesat e institucioneve të edukimit dhe arsimimit.*

.....

*- nenet: 8 (pikat 2.1, 2.6, 2.9), 10 dhe 19 pika 2 për shkolla, institucionet e edukimit, shkolla të larta;”*

Në paragrafin e fundit të nenit 30, përcaktohet se: “Përveç elementeve të përshtatjes në pjesët e objektit me destinacion kryerjen e veprimtarisë së biznesit, objekti për çdo pjesë tjetër të tij duhet të përshtatet me elementë sipas funksionit dhe detyrimisht përshtatjet sipas përcaktimit nga pika 1 - 15 të këtij neni”.

Referuar parashikimeve të mësipërme të bëra në VKM nr. 1503/2008, ekzistojnë rregulla dhe standarde të mirëpërcaktuara dhe të detyrueshme për zbatim, të cilat duhet të përmbushin ndërtesat e institucioneve të edukimit dhe arsimimit, për të eliminuar pengesat/barrierat dhe për të garantuar aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara.

Bazuar në provat e administruara gjatë shqyrtimit të ankesës rezultoi e provuar se, godina e DROFPP nr. 1, Tiranë nuk plotëson kushtet e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara, pasi:

- Rampa nuk plotëson standardet e kërkuara në pikën 2.11<sup>12</sup> të nenit 8 të VKM nr. 1503/2008.
- Pjesa hyrëse dhe korridoret e godinës nuk plotësojnë kërkesat e nenit 3, pikat 19, 20, 21 dhe 22 të VKM nr. 1503/2008 (përpunimi relievor, vija relievore drejtuese, vija relievore paralajmëruese, fusha relievore paralajmëruese).
- Parkimi i dedikuar për personat me AK nuk ka sinjalistikën horizontale dhe vertikale të domosdoshme për plotësimin e standarteve të kërkuara në pikën 3.3<sup>13</sup> të nenit 8, të pjesës së dytë të rregullores.

---

<sup>12</sup> 2.11 Platformat e pjerrëta (rampat).

Konsiderohet i arritshëm kalimi i një disnivele deri në 320 cm nëpërmjet platformave të pjerrëta të vendosura njëra pas tjetrës. Rampa duhet të plotësoj kushtet:

- pjerrtësi të lejuar deri në 1:20 (5%);
- gjerësi së paku 120 cm në hapësirat e jashtme, gjegjësisht më së paku 90 cm në hapësirat e brendshme;
- shesh pushime horizontale me dimensione minimale prej 150 x 150 cm ose 140 x 170 cm në drejtim të tërthortë dhe 170 cm në drejtim gjatësor nga ana e kundërt e lëvizjes, e vendosur në çdo 10 m të gjatësisë së rampës,
- sipërfaqe relievore kundër rrëshqitëse;
- rrethim të ndërtuar me dorëza mbajtëse në pjesën e pambrojtur, ose në pamundësi një bordurë të paktën me 10 cm lartësi;
- dorëzë mbajtëse me diametër 4 cm, e formatuar në mënyrë që mund të kapet me pëllëmbë, e vendosur në dy lartësi - prej 60 cm dhe 90 cm;
- rrethim i rampës, i cili gjendet në hapësirat e jashtme, dorëza mbajtëse e tij e realizuar në mënyrë të tillë që të mos jetë e ndjeshme nga ndryshimet termike; .....

<sup>13</sup> 3.3 Parkimet duhet të vendosen në masën minimale 1 në çdo 50 vende makinash, me gjerësi jo më të vogël se 320 cm dhe e rezervuar falas për makinat e personave me aftësi të kufizuara. Të ashtuquajtura vende makinash, të sinjalizuara, caktohen në ngjitje të vendkalimeve të këmbësorëve dhe në afërsi të hyrjes së ndërtesave ose pajisjeve. Me qëllim lehtësimin e transferimit të personit në karrige me rrota në kushte të njëjta atmosferike, preferohet që vendet e makinave të rezervuara të jenë të pajisura me

Garantimi i aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara, sikurse më sipër rezulton, kërkon aplikimin e një sërë standardesh dhe kriteresh teknike, të cilat janë miratuar me VKM nr. 1503/2008. Është respektimi në tërësinë e tyre, i këtyre standardeve dhe kriterëve teknike që mundëson heqjen e barrierave/pengesave për personat me aftësi të kufizuara dhe mundëson që personat me aftësi të kufizuara të kenë akses në arsim në baza të barabarta me të tjerët. Ekzistenca e pengesave/barrierave infrastrukturore në godinën e DROFPP nr. 1, Tiranë, sjell si pasojë që personave me aftësi të kufizuara t’ju mohohet aksesimi për të marrë shërbimet e ofruara lidhur me arsimin dhe formimin profesional.

Referuar VKM nr. 110, datë 02.03.2022 *“Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë”*, fusha e arsimit dhe formimit profesional është nën përgjegjësinë e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, e cila është përgjegjëse për zhvillimin e politikave shtetërore për arsimin dhe formimin profesional. Ofruesit e AFP-së janë institucione publike ose private, në varësi të ministrisë përgjegjëse për AFP-në, në menaxhimin e AKPA. Referuar Kreut III, pikës 8 të VKM-së nr. 554, datë 31.07.2019 *“Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të AKPA”*, përcaktohet se: *“AKPA-ja, në nivel qendror, kryen detyrat, si më poshtë vijon: a) organizon dhe menaxhon drejtoritë rajonale dhe zyrat vendore të punësimit për garantimin e nivelit të cilësisë së shërbimeve të ofruara, për punëkërkuarit, të punësuarit që kërkojnë të ndryshojnë punë, personat me aftësi të kufizuara dhe grupet e veçanta dhe punëdhënësit;.....”*.

Sa më sipër, rezulton se është në përgjegjësinë e MFE-së dhe AKPA-së që të sigurojë aksesueshmërinë e ndërtesave të arsimit dhe formimit profesional. Objekt i ankesës në shqyrtim është godina e DROFPP nr. 1, Tiranë, e cila është pjesë e sistemit të arsimit dhe formimit profesional dhe është një godinë në juridiksionin e MFE-së dhe në menaxhimin e AKPA-së. Rrjedhimisht, Komisioneri arrin në përfundimin se, është në përgjegjësinë e MFE-së dhe AKPA-së, si ministria dhe agjencia përgjegjëse për arsimin dhe formimin profesional në juridiksionin e të cilës është godina e DROFPP nr. 1, Tiranë, të sigurojë aksesueshmërinë e ndërtesës së kësaj godine.

Bazuar në sa më sipër, Komisioneri arrin në përfundimin se, godina e DROFPP nr. 1, Tiranë, nuk përmbush standardet teknike të miratuara për të siguruar aksesueshmërinë për personat me aftësi të kufizuara, e për rrjedhojë MFE dhe AKPA, nuk kanë përmbushur detyrimet ligjore në fuqi në lidhje me sigurimin e aksesueshmërisë për ankuesen. Meqënëse aksesueshmëria, është një parakusht që personat me aftësi të kufizuara të marrin pjesë në baza të barabarta me të tjerët në shoqëri, për të jetuar në mënyrë të pavarur, Komisioneri vlerëson se dështimi për të përmbushur standardet teknike të miratuara me qëllim sigurimin e aksesueshmërisë, e ka ekspozuar S.C ndaj një trajtimi të padrejtë dhe më pak të favorshëm dhe në rastin konkret në raport me personat e tjerë që nuk kanë aftësi të kufizuara.

## **B. Shkaku i mbrojtur**

---

mbulesë. Vendparkimi për PAK duhet të vendoset afër hyrjes së ndërtesës. Vendparkimi për automjete, kur parkimi bëhet pjerrtas apo për së gjati në raport me trotuarin për këmbësorët, madhësia e tij duhet të jetë 370 x 500 cm, figura 32 shtojca B.

---

Adresa: Rruga e Durrësit, Nr.27, Kodi Postar 1001, Tiranë, Tel: +355 4 2431078, e-mail: [info@kmd.al](mailto:info@kmd.al), web: [www.kmd.al](http://www.kmd.al)

Mbështetur në nenin 2 , të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në ushtrimin e detyrës së tij siguron mbrojtjen efektive nga diskriminimi dhe çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin për një nga shkaqet që parashikon ky ligj. Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi ndalon situatat kur persona ose grupe personash në një situatë të njëjtë trajtohen në mënyra të ndryshme, dhe situatat kur personat ose grupet e personave në situata të ndryshme trajtohen njësoj.

Në nenin 1, të LMD, përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Referuar nenit 1, të LMD, shkak i diskriminimit “aftësia e kufizuar” i pretenduar nga pala ankuese, konsiderohet si shkak i mbrojtur, pasi jo vetëm parashikohet si i tillë në bazën ligjore të sipërpërmendur, por edhe sepse ekzistojnë prova të mjaftueshme<sup>14</sup>, që provojnë se ankuesja e mbart këtë shkak.

### **C. Lidhja e trajtimit të padrejtë më pak të favorshëm me shkakun e mbrojtur.**

KDPAK parashikon në nenin 9, të saj, të drejtën për aksesueshmëri si një të drejtë më vete, përpos parashikimit të aksesueshmërisë si një nga parimet mbi bazën e të cilit duhet të interpretohen të gjithë të drejtat e tjera për personat me aftësi të kufizuara. Neni 9, i KDPAK vendos mbi shtetet detyrimin për të marrë masat e duhura për të siguruar akses për personat me aftësi të kufizuar, në baza të barabarta me të tjerët, duke përfshirë këtu, aksesin në arsim. (neni 9/1 KDPAK).

E drejta për arsim, është një e drejtë kushtetuese, e parashikuar në nenin 57 të Kushtetutës, e cila duhet të sigurohet mbi baza të barabarta dhe pa diskriminim. Rëndësia e të drejtës për edukim mbështetet në atë që, ushtrimi i shumë të drejtave të tjera, varet në radhë të parë nga realizimi i të drejtës për arsim, siç theksohet në Komentin e Përgjithshëm Nr. 13 (1999) “Mbi të drejtën për arsim”, të Komitetit të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, E drejta për arsim garantohet në kuadër të shumë marrëveshjeve ndërkombëtare të cilat vendi ynë i ka ratifikuar duke u bërë kështu pjesë e sistemit të brendshëm ligjor jo vetëm të detyrueshme për t’u zbatuar por bazuar në nenin 116 të Kushtetutës në hierarkinë e normave juridike ato renditen menjëherë pas Kushtetutës, të tilla si: Konventa e UNESCO Kundër Diskriminimit në Arsim; Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike Social dhe Kulturore, garanton të drejtës për arsim në nenet 13 e 14; Protokollin nr. 1 (neni2) i Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut “E drejta për arsim”, Konventa e OKB-së “Mbi të drejtat e fëmijës” dhe Konventa e OKB-së “Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara” (KDPAK).

<sup>14</sup> Referuar Librezës nr. 01167, nr. i serisë 002694, S.C është PAK grupi I (parë).

KDPAK përfaqëson standardin më të lartë të të drejtave të personave me aftësi të kufizuara. Kjo Konventë në nenin 24 të saj, njeh të drejtën e personave me aftësi të kufizuara për arsim. Sipas nenit 24, të KDPAK, e drejta për arsim e personave me aftësi të kufizuara realizohet pa diskriminim dhe në bazë të mundësive të barabarta, nëse garantohet një sistem edukimi gjithëpërfshirës.

Komisioneri vlerëson se politikat e punësimit për personat me AK janë të shoqëruara dhe me ato të aftësisimit për punë, që konsiderohet si një faktor i rëndësishëm që i paraprin punësimit të personave me AK. Një nga elementët kryesorë, që ndikon në rritjen e punësimit të personave me aftësi të kufizuara, është dhe aftësimi i tyre nëpërmjet ndjekjes së kurseve të formimit profesional.

Parimi i barazisë dhe i mosdiskriminimit, sanksionohet nga Kushtetuta në nenin 18, si një parim i përgjithshëm që përshkon të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj ai duhet të gjejë shprehjen e tij në të gjithë legjislacionin shqiptar si dhe të zbatohet nga të gjithë, si nga institucionet edhe nga individët.

Gjykata Kushtetuese në disa vendime të saj ka interpretuar nenin 18 të Kushtetutës, si dhe ka theksuar se parimi i barazisë synon që të gjithë të jenë të barabartë në ligj dhe përpara ligjit, jo vetëm në të drejtat themelore të parashikuara në Kushtetutë por edhe në të drejtat e parashikuara nga ligjet e tjera në fuqi. Gjykata është shprehur se: *“Barazia në ligj dhe para ligjit nuk do të thotë që të ketë zgjidhje të njëllajta për individë ose kategori personash që janë në kushte objektivisht të ndryshme. Barazia përpara ligjit dhe në ligj presupozon barazinë e individëve që janë në kushte të barabarta”, si dhe “Vetëm në raste përjashtimore dhe për shkaqe të arsyeshme dhe objektive mund të përliqet trajtimi i ndryshëm i kategorive të caktuara që përfitojnë nga kjo e drejtë.”* (shih vendimet nr. 39, datë 16.10.2007, nr. 4 datë 12.02.2010, nr. 34, datë 20.12.2015, të Gjykatës Kushtetuese)

Neni 14 i Konventës Evropiane për Drejtat e Njeriut (KEDNJ), ndalon diskriminimin në gëzimin e të drejtave dhe lirive të përcaktuara në të, duke mos parashikuar një të drejtë të veçantë në lidhje me aksesueshmërinë, ndërkohë që Protokollin 12-të i KEDNJ-së, i cili është ratifikuar nga Shqipëria, ndalon diskriminimin në lidhje me *“gëzimin e çdo të drejte të parashtruar nga ligji”* dhe kështu ofron mbrojtje më të madhe se sa neni 14, i cili lidhet vetëm me të drejtat e garantuara nga KEDNJ-ja. Në veçanti, fusha e mbrojtjes sipas nenit 1, të Protokollit të 12, të KEDNJ përfshin rastet kur personi është diskriminuar: *“a) në gëzimin e çdo të drejte ligjore të njohur shprehimisht me ligj të veçantë; b) në gëzimin e çdo të drejte që rrjedh nga një detyrim i qartë i autoritetit publik sipas legjislacionit të brendshëm, sa kohë autoriteti ka detyrimin të dëshmojë një sjellje të caktuar mbi bazën e ligjit të brendshëm; c) nga autoriteti publik në ushtrimin e kompetencës diskrecionare; d) nga çdo akt apo mosveprim tjetër i autoritetit publik”.*

Gjithashtu, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), në mënyrë të vazhdueshme ka interpretuar se trajtimi i diferencuar është diskriminues nëse ai nuk bazohet në ndonjë justifikim

objektiv dhe të arsyeshëm, domethënë, nëse trajtimi i diferencuar nuk ndjek një qëllim legjitim ose nëse nuk ekziston një marrëdhënie e arsyeshme të proporcionalitetit ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të realizohet<sup>15</sup>. Sipas GJEDNJ-së, e drejta për të mos u diskriminuar e garantuar nga KEDNJ, gjithashtu çënohet kur pa një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm shtetet dështojnë që të trajtojnë ndryshe personat situata e të cilëve është objektivisht e ndryshme<sup>16</sup>. GJEDNJ, shprehet se, ndalimi që rrjedh nga neni 14 do të krijojë detyrime pozitive për shtetet kontraktuese për të bërë dallimet e nevojshme ndërmjet personave ose grupeve, rrethanat e të cilëve janë në mënyrë të rëndësishme dhe domethënëse të ndryshme<sup>17</sup>. Për më tepër, GJEDNJ, shprehet se, neni 14, nuk e ndalon një shtet anëtar që t'i trajtojë grupet ndryshe për të korigjuar "pabarazitë faktike" ndërmjet tyre; në të vërtetë, në rrethana të caktuara, dështimi në përpjekje për të korigjuar pabarazinë nëpërmjet trajtimit të ndryshëm, mund të shkaktojë në vetvete një shkelje të nenit 14<sup>18</sup>.

LMD, është një ligj i cili është miratuar në bazë dhe në zbatim të nenit 18, të Kushtetutës. Në bazë të LMD, jo çdo diferencë në trajtim, konsiderohet diskriminim. Neni 6, i LMD, përcakton: "Ndalimi i diskriminimit i përshkruar nga ky ligj nuk zbatohet në rastet kur ka një qëllim objektivisht të justifikueshëm dhe të përlegjur në bazë të Kushtetutës, të marrëveshjeve apo akteve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë dhe legjislacioni në fuqi".

Sipas nenit 3, pika 1 të LMD, "diskriminimi" përkufizohet si: "çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi".

Në pikën 1, të nenit 5, të LMD, sanksionohet se ndalimi i diskriminimit, sipas formulimit vijues: "1. Ndalohet diskriminimi për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe mosmarrja në shqyrtim, sipas rasteve të përmendura në nenin 3 të këtij ligji, e një ankimi ose procedure, si dhe çdo formë tjetër sjelljeje që pengon zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë."

Në Kreun III, të LMD, parashikohet një mbrojtje të posaçme nga diskriminimi në fushën e arsimit. Konkretisht, në nenin 17, pika 1, të LMD parashikohet: "1. Ndalohet çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji..... "

Barra e provës në çështjet e diskriminimit, është objekt i rregullimit të veçantë sipas LMD. Bazuar në nenin 33 pika 7/1, të LMD, sanksionohet se: "Në rastet kur pala ankuese paraqet fakte mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet

<sup>15</sup> Shih: *Molla kundër Greqisë*, Vendim i Dhomës së Madhe, 2018, prg. 135; *Fabián kundër Hungarisë*, Vendim i Dhomës së Madhe 2017, prg. 113; *Abdulaziz, Cabales dhe Balkandali kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 1985, prg.72.

<sup>16</sup> Shih: Çështja *Thlimmenos kundër Greqisë* [GC], nr. 34369/97, prg. 44, GJEDNJ 2000-IV; Çështja *J.D dhe A kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr.32949/17 dhe 34614/17, prg. 84, 24 tetor 2019.

<sup>17</sup>Shih: Çështja *J.D dhe A kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr.32949/17 dhe 34614/17, prg. 84, 24 tetor 2019.

<sup>18</sup> Shih: Çështjen *Horváth dhe Kiss kundër Hungarisë*, nr. 11146/11, datë 29.01.2013, prg. 101; Çështjen *Thlimmenos*, cituar më lart, prg. 44; Çështjen *D.H. dhe të tjerët kundër Republikës Çeke* (GC), nr.57325/00, GJEDNJ 2007-IV, prg.175).

se ka pasur diskriminim, pala tjetër, kundër së cilës është paraqitur ankesa, detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim”. Të njëjtin rregullim, në lidhje me barrën e provës parashikohet edhe nga Kodi i Procedurave Administrative. Konkretisht, në nenin në nenin 82, pika 2 të Kodit të Procedurave Administrative përcaktohet se: “Në rastet kur pala paraqet prova mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër dhe/ose organi publik detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj”.

Sa më sipër, pala ankuese duhet të krijojë një prezumim të diskriminimit (diskriminimi *prima facie*), barra më pas kalon tek subjekti që pretendohet se ka kryer diskriminimin, i cili duhet të tregojë se ndryshimi në trajtim nuk është diskriminues. Kjo mund të bëhet:

1. Ose duke vërtetuar se nuk ka ndonjë lidhje shkakësore midis shkakut të mbrojtur dhe trajtimit të pafavorshëm apo të pabarabartë.
2. Ose duke provuar që megjithëse ky trajtim është i lidhur me shkakun e pretenduar, ka një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv. Nëse subjekti që pretendohet se ka konsumuar sjelljen diskriminuese nuk është në gjendje të provojë një të dyja, atëherë do të jetë përgjegjëse për diskriminimin.<sup>19</sup>

Bazuar në faktet dhe provat e administruara si dhe detyrimet që burojnë nga legjislacioni në fuqi, rezultoi e provuar se godina e DROFPP nr. 1, Tiranë, nuk përmbush standardet e miratuara për sigurimin e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara. Mospërmbushja e standardeve teknike të miratuara me qëllim sigurimin e aksesueshmërisë, ka ekspozuar ankuesen si person me aftësi të kufizuar ndaj një trajtimi të padrejtë dhe më pak të favorshëm dhe në rastin konkret në raport me personat e tjerë që ndjekin kurset në godinën e DROFPP nr. 1, Tiranë. Në këto kushte, Komisioneri vlerëson se, ankuesja është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak se mospërmbushja e standardeve teknike e ka vendosur atë përpara pengesave dhe barrierave, në raport me pjesën tjetër të personave që nuk kanë aftësi të kufizuara dhe nuk përballen me barriera/pengesa sikundër personat me aftësi të kufizuara.

Sa më sipër, rezulton plotësisht e provuar lidhja shkakësore midis shkakut të mbrojtur që në rastin konkret është aftësia e kufizuar dhe trajtimit të pafavorshëm dhe të pabarabartë të cilit i është nënshkruar ankuesja, për shkak të mosrespektimit të standardeve të aksesueshmërisë të miratuar nga aktet në fuqi, si më sipër janë cituar.

Komisioneri vlerëson se, bazuar në faktet dhe provat e administruara, jemi në kushtet kur mund të prezumohet se ka patur diskriminim, pra të diskriminimit *prima facie*. Rrjedhimisht, bazuar në standardin e provës, MFE dhe AKPA kishin barrën e provës që të provonin se trajtimi i pabarabartë dhe më pak i favorshëm të cilit i është nënshtruar ankuesja në godinën e DROFPP nr. 1, Tiranë, ka një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm.

<sup>19</sup> [https://fra.europa.eu/sites/default/files/fra\\_uploads/fra-2018-handbook-non-discrimination-law-2018\\_en.pdf](https://fra.europa.eu/sites/default/files/fra_uploads/fra-2018-handbook-non-discrimination-law-2018_en.pdf), fq.232.

Aksesueshmëria është një parakusht për gëzimin efektiv të të drejtave të ndryshme nga personat me aftësi të kufizuara, përfshi edhe të drejtën për arsim. Megjithatë sipas KDKPAK, sigurimi i aksesueshmërisë arrihet përmes realizimit progresiv.

Referuar Komentit të Përgjithshëm Nr.2 (2014), mbi nenin 9 “Aksesueshmëria”, të miratuar nga Komiteti për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, parashikohet se: *“E drejta për aksesueshmëri për personat me aftësi të kufizuara sigurohet përmes zbatimit të rreptë të standardeve të aksesueshmërisë. Pengesat për të hyrë në objektet ekzistuese, ambientet, mallrat dhe shërbimet e synuara ose të hapura për publikun duhet të hiqen gradualisht në një mënyrë sistematike dhe, më e rëndësishmja, të monitoruar vazhdimisht, me qëllim që të sigurohet aksesueshmëria e plotë”*.

Kjo qasje parashikohet edhe në nenin 4, të ligjit nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”, në bazë të të cilit është miratuar VKM nr. 1074, datë 23.12.2015 “Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara”. Në këtë VKM, parashikohet se planifikimi për realizimin e përshtatjes, nga ana e subjekteve të detyruara, do të realizohet në mënyrë progresive (Kreu I, pika 12).

Sipas pikës 10, të kreut I, të VKM-së Nr.1074, datë 23.12.2015, parashikohet gjithashtu se: *“Në planin e masave përfshihet detyrimi i subjektit për: a) evidentimin e objekteve ekzistuese dhe të shërbimeve, për të cilat nevojitet përshtatshmëria; b) planifikimin progresiv të fondeve të nevojshme për përshtatjen; c) përcaktimin e afatit kohor për realizimin e përshtatshmërisë”*.

VKM nr. 1074/2015 vijon më tej duke parashikuar në pikat 9, 10, 13 dhe 14 të tij se : *“9. Çdo subjekt, që ofron shërbime për publikun, është i detyruar që të miratojë një plan masash për zbatimin e kërkesave të këtij vendimi brenda 6 (gjashtë) muajve nga hyrja e tij në fuqi. 10. Në planin e masave përfshihet detyrimi i subjektit për: a) evidentimin e objekteve ekzistuese dhe të shërbimeve, për të cilat nevojitet përshtatshmëria; b) planifikimin progresiv të fondeve të nevojshme për përshtatjen; c) përcaktimin e afatit kohor për realizimin e përshtatshmërisë. 13. Çdo subjekt, sipas pikës 4, të këtij vendimi, ka detyrimin që, brenda 12 (dymbëdhjetë) muajve nga data e miratimit të planit të masave, të fillojë punën për të realizuar procesin e përshtatshmërisë lidhur me objektet ekzistuese dhe shërbimet e ofruara.”*

Realizimi progresiv do të thotë që heqja e pengesave dhe sigurimi i aksesueshmërisë duhet të sigurohet në mënyrë të vazhdueshme dhe sistematike, por në çdo rast në mënyrë të qëndrueshme, efektive dhe brenda një kornize afatshkurtër dhe afatmesme.

Komentit të Përgjithshëm Nr.2 (2014), mbi nenin 9 “Aksesueshmëria”, i miratuar nga Komiteti për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, përcakton se: *“Si minimum, situatat e mëposhtme në të cilat mungesa e aksesit ka penguar një person me aftësi të kufizuara të ketë akses në një shërbim ose objekt të hapur për publikun, duhet të konsiderohen si akte të ndaluara të diskriminimit të bazuar në aftësinë e kufizuar: (a) Kur shërbimi ose objekti është krijuar pasi*

*janë prezantuar standardet përkatëse të aksesueshmërisë; (b) Aty ku aksesimi mund të ishte dhënë në objekt ose shërbim (kur ai u krijua) nëpërmjet përshtatjes së arsyeshme.....”.*

Nga faktet dhe provat e administruara rezultoi se, godina e DROFPP nr. 1, Tiranë, është bërë rikonstruksion në vitin 2007. Pra, rezulton se ky objekt arsimor është ndërtuar përpara miratimit të standardeve të aksesueshmërisë sipas VKM nr. 1503/2008.

Sipas informacionit të përcjellë nga AKPA me shkresën nr. 3082/8, datë 10.11.2022, rezulton se, në kuadër të zbatimit të Strategjisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive, gjatë periudhës 2019-2022 janë rikonstruktuar 6 shkolla të mesme profesionale. Referuar po kësaj shkrese, AKPA, informon se, gjatë viteve 2023-2024 do jenë në proces rikonstruksioni dhe 5 shkolla të mesme profesionale, por që nuk është planifikuar asnjë investim për rikonstruksion të qendrave të formimit profesional.

AKPA nuk vuri në dispozicion asnjë informacion në lidhje me planifikimin progresiv të fondeve të nevojshme për përshtatjen dhe afatin kohor për realizimin e përshtatshmërisë në qendrat e formimit profesional në varësi të saj. Rezulton se, MFE dhe AKPA nuk kanë marrë asnjë masë për të siguruar aksesueshmërinë në godinën e DROFPP nr. 1, Tiranë, në juridiksionin e saj për personat me aftësi të kufizuara.

Komisioneri vlerëson se, nga ana e MFE dhe AKPA nuk ka shprehje vullneti, për të punuar drejt realizimit gradual të aksesit universal, brenda kufijve të buxhetit në dispozicion.

Duke mbajtur në konsideratë natyrën dhe llojin e ndërtesës që është objekt i ankesës në shqyrtim, si një institucion i formimit profesional, Komisioneri vlerëson se, godina e DROFPP nr. 1, Tiranë, është një ndërtesë që frekuentohet nga persona me AK<sup>20</sup>, ndryshe nga ndërtesa të tjera që në varësi të natyrës së shërbimeve që ofrojnë, mund të mos lindi nevoja që të frekuentohen në mënyrë të përditshme. Në jurisprudencën e saj GJEDNJ ka vendosur theksin tek aksesimi në arsim dhe godinat arsimore (*Enver Shahin kundër Turqisë, nr. 23065/12, vendimi datë 30 janar 2018 dhe Çam kundër Turqisë, nr. 51500/08, vendimi datë 23 shkurt 2016, Arnar Helgi Lárusson kundër Islandës, nr. 23077/19, vendimi datë 31.5.2022*).

Sipas Komentit të Përgjithshëm Nr. 13 (1999) “*Mbi të drejtën për arsim*” të Komitetit të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, arsimi në të gjitha format e tij dhe në të gjitha nivelet duhet të ketë karakteristikat si vijon, të cilat janë thelbësore dhe të ndërlidhura me njëra tjetrën: *disponueshmëria, aksesueshmëria, pranueshmëria, përshtatshmëria*. Sipas Komentit të Përgjithshëm nr. 4 (2016) “*Mbi të drejtën për arsim gjithëpërfshirës*”, të Komitetit të OKB-së Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, për të vlerësuar garantimin e të drejtës për arsim gjithëpërfshirës, duhet të merren në konsideratë të katërt këta elementë apo karakteristika. Nën karakteristikën e aksesueshmërisë që duhet të ketë arsimit gjithëpërfshirës, në Komentin e Përgjithshëm Nr. 4, në paragrafin 22, Komiteti për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, sqaron ndër të tjera se: “*Në përputhje me nenin 9 të*

<sup>20</sup> Referuar shkresës nr. 791, datë 22.08.2022 të DROFPP nr. 1, Tiranë.

*Konventës dhe me Komentin e Përgjithshëm të Komitetit nr. 2 (2014) “Mbi aksesueshmërinë”, institucionet dhe programet arsimore duhet të jenë të aksesueshme për të gjithë, pa diskriminim. I gjithë sistemi arsimor duhet të jetë i aksesueshëm, duke përfshirë ndërtesat, mjetet e informacionit dhe komunikimit, kurrikulën, materialet arsimore, metodat e mësimdhënies, vlerësimet dhe shërbimet gjuhësore dhe mbështetëse Shtetet palë duhet të ndalojnë dhe dënojnë ndërtimin e çdo infrastrukture arsimore në të ardhmen që është e paaksesueshme dhe të krijojnë një mekanizëm efikas monitorimi dhe kornizë kohore për t'i bërë të aksesueshme të gjitha mjediset ekzistuese arsimore...”.*

Në Komentin e Përgjithshëm nr. 4 (2016) “Mbi të drejtën për arsim gjithëpërfshirës”, të Komitetit të OKB-së Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, në paragrafët 39, 41 e 45, të tij, citohet se: “39. Shtetet palë duhet të respektojnë, mbrojnë dhe përmbushin secilën nga veçoritë thelbësore të së drejtës për arsim gjithëpërfshirës: disponueshmërinë, aksesueshmërinë, pranueshmërinë dhe përshtatshmërinë. .... Detyrimi për të përmbushur kërkon marrjen e masave që mundësojnë dhe ndihmojnë personat me aftësi të kufizuara të gëzojnë të drejtën për arsim, për shembull, duke siguruar që institucionet arsimore të jenë të aksesueshme ..... 41. Realizimi progresiv nuk cenon ato detyrime që zbatohen menjëherë. Siç ka deklaruar Komiteti për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore në Komentin e tij të Përgjithshëm nr. 3 (1990) mbi natyrën e detyrimeve të shteteve palë, shtetet palë kanë një detyrim thelbësor minimal për të siguruar, së paku, nivelet minimale thelbësore të secilit aspekt, të së drejtës për arsimim. Prandaj, shtetet palë duhet të zbatojnë të drejtat thelbësore të mëposhtme me efekt të menjëhershëm:(a) Mosdiskriminimi në të gjitha aspektet e arsimit dhe që përfshin të gjitha bazat e diskriminimit të ndaluara ndërkombëtarisht. Shtetet palë duhet të sigurojnë mospërrjashtim nga arsimi për personat me aftësi të kufizuara dhe të eliminojnë disavantazhet strukturore për të arritur pjesëmarrje efektive dhe barazi për të gjithë personat me aftësi të kufizuara. Ata duhet të ndërmarrin urgjentisht hapa për të hequr të gjitha format ligjore, administrative dhe forma të tjera të diskriminimit që pengojnë të drejtën e aksesit në arsimin gjithëpërfshirës. ....(c) Komiteti u kërkon shteteve palë që të sigurojnë akses dhe përfundim të arsimit cilësor për të gjithë fëmijët dhe të rinjtë, në të paktën 12 vjet arsim fillor dhe të mesëm, falas, të financuar publikisht, gjithëpërfshirës dhe me cilësi të barabartë, nga të cilët të paktën nëntë vjet janë të detyrueshëm..... 45. .... Për të trajtuar diskriminimin sistematik dhe strukturor dhe për të garantuar “përfitim të barabartë nga ligji”, shtetet palë duhet të marrin masa afirmative, të tilla si heqja e barrierave arkitekturore dhe komunikative ose pengesa të tjera në arsimin e zakonshëm.”

Duke mbajtur në konsideratë gjithë sa më sipër, Komisioneri konstaton se, MFE dhe AKPA, në mënyrë të pajustificuar, nuk kanë ndërmarrë masa për heqjen e pengesave dhe sigurimin e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara në godinën e DROFPP nr. 1, Tiranë.

Referuar Komentit të Përgjithshëm Nr.2 (2014), mbi nenin 9 “Aksesueshmëria”, të miratuar nga Komiteti për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, parashikohet se:

“.....25. Aksesueshmëria lidhet me grupet, ndërsa përshtatja e arsyeshme lidhet me individët. Kjo do të thotë se detyra për të ofruar akses është një detyrë ex ante. Prandaj, shtetet palë kanë për detyrë të ofrojnë aksesueshmërinë përpara se të marrin kërkesa individuale për të hyrë ose përdorur një vend ose shërbim..... Standardet e aksesueshmërisë duhet të jenë të gjera dhe të standardizuara..... Në përputhje me Konventën, shtetet palë nuk lejohen të përdorin masat shtrënguese si justifikim për të shmangur sigurimin e aksesueshmërisë graduale për personat me aftësi të kufizuara. Detyrimi për të zbatuar aksesueshmërinë është i pakushtëzuar, pra subjekti i detyruar që të sigurojë aksesueshmërinë nuk mund të justifikojë mosveprimin për t'a siguruar atë, duke iu referuar barrës për sigurimin e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara. Detyrimi për përshtatjen e arsyeshme, përkundrazi, ekziston vetëm nëse zbatimi nuk përbën barrë të tepruar për subjektin.

26. Detyra për të ofruar përshtatje të arsyeshme është një detyrë ex nunc, që do të thotë se është e detyrueshme që nga momenti kur një individ me dëmtim ka nevojë për të në një situatë të caktuar..... Këtu, standardet e aksesueshmërisë mund të jenë një tregues, por mund të mos merren si urdhërues. Përshtatja e arsyeshme mund të përdoret si një mjet për të siguruar akses për një person me aftësi të kufizuara në një situatë të caktuar.....”.

GJEDNJ në jurisprudencën e saj, lidhur me diskriminimin e personave me aftësi të kufizuara, ka mbajtur qëndrimin se: “duke pasur parasysh nevojën për të parandaluar diskriminimin ndaj personave me aftësi të kufizuara dhe për të nxitur pjesëmarrjen dhe integrimin e tyre të plotë në shoqëri, marzhi i vlerësimit që gëzojnë shtetet në vendosjen e trajtimit të ndryshëm ligjor për personat me aftësi të kufizuara është ndjeshëm i reduktuar<sup>21</sup> dhe se për shkak të çënueshmërisë së veçantë të personave me aftësi të kufizuara, një trajtim i tillë do të kërkonte arsye shumë të rëndësishme për t'u justifikuar<sup>22</sup>.”

**Komisioneri arrin në përfundimin se, mosplotësimi i standardeve të aksesueshmërisë në godinën e DROFPP nr. 1, Tiranë, ka sjellë mohim të aksesit për ankuesen, në baza të barabarta me të tjerët, dhe se MFE dhe AKPA nuk arritën të provojnë se kanë marrë masat e duhura për të realizuar në mënyrë progresive aksesueshmërinë në këtë objekt.**

**Në këto kushte, Komisioneri arrin në përfundimin se nuk ka asnjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm për trajtimin e padrejtë dhe më pak të favorshëm të cilit i është nënshtruar ankuesja dhe rrjedhimisht trajtimi i padrejtë dhe më pak i favorshëm i saj, përbën diskriminim sipas parashikimeve të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.**

Bazuar në nenin 33, pika 10 të LMD, përcaktohet se: “Vendimi përmban rregullimet dhe masat e duhura, duke caktuar edhe një afat për kryerjen e tyre”, ndërsa bazuar në nenin 33, pika 12, të lmd, përcaktohet: “Kur vendos masën, komisioneri siguron që ajo të jetë: a) e efektshme dhe parandaluese; dhe b) në përputhje me gjendjen që e shkaktoi vendosjen e masës”. LMD, në

<sup>21</sup> Shih: *Glor kundër Zvicrës*, nr.13444/04, prg. 84, GJEDNJ 2009.

<sup>22</sup> Shih: *Guberina kundër Kroacisë*, nr. 23682/13, 73, GJEDNJ 2016.

nenin 33/10 të tij, nuk ka përcaktuar masat që duhen marrë për rregullimin e situatës diskriminuuese, por e ka lënë në diskrecionin e Komisionerit. Pra, Komisioneri rast pas rasti, vendos se cilat janë rregullimet dhe masat që duhen marrë në mënyrë që të sigurojë mbrojtjen efektive nga diskriminimi të personave që pretendojnë se janë viktima të diskriminimit. LMD, nëpërmjet nenit 33/12, ka vendosur kriteret që duhet të ndjekë Komisioneri në përcaktimin e masës që ai jep nëpërmjet vendimeve të tij.

Komisioneri ka konstatuar sjellje diskriminuuese ndaj S.C, pasi rezultoi se MFE dhe AKPA nuk kanë marrë masa për të siguruar aksesueshmërinë për S.C në godinën e DROFPP nr. 1, Tiranë. Për rrjedhojë edhe masa rregulluese duhet të jetë në funksion të rregullimit të situatës së diskriminimit dhe garantimin e aksesueshmërisë për S.C, sipas standardeve të miratuara dhe për të gjitha kategoritë e personave me aftësi të kufizuara.

### **PËR KËTO ARSYE :**

Bazuar në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “*Për mbrojtjen nga diskriminimi*”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### **V E N D O S I :**

1. Konstatimin e diskriminimit të S.C nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive.
2. Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive, të marrin masa për të siguruar në mënyrë të përshtetshme aksesueshmërinë në godinën e DROFPP nr. 1, Tiranë, në përputhje me standardet ligjore në fuqi dhe për të gjitha kategoritë e personave me aftësi të kufizuara.
3. Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive, të marrin masa për hartimin e një plani masash për evidentimin e të gjitha objekteve, në të cilat ofrohet formimi profesional, për të cilat nevojitet përshtatshmëria, me qëllim parandalimin e situatave diskriminuuese ndaj të gjithë personave me aftësi të kufizuara. Pjesë e planit të masave duhet të jetë planifikimi progresiv i fondeve të nevojshme për përshtatjen dhe përcaktimi i afateve kohore për realizimin e përshtatshmërisë.
4. Bazuar në nenin 33 pika 11, të ligjit “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive, detyrohet që brenda 30 (tridhjetë) ditëve të njoftojë Komisionerin, lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.
5. Moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë.
6. Kundër këtij vendimi lejohet ankimi në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja e tij.

**KOMISIONERI**

**Robert GAJDA**